

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

ALTA HALUCI

LEKSIKU URBAN NË FILLIMET E KRIJIMTARISË SË POETIT ISMAIL KADARE

Poezia e Ismail Kadaresë tërhoqi vëmendjen që në fillimet e saj, sepse pikërisht sillte mendimin e ri përmes përgjithësime të gjera, sepse ajo transmetonte, përmes një lirizmi të ndjerë e spontan ndjenja të shprehura me figuracion konkret, të zhveshura nga retorika dhe notat odike që e linin lexuesin të ftohtë ndaj poezisë.

Poezia e Kadaresë ka një diapazon shumë të gjerë, atë e karakterizon një pasuri e madhe idesh dhe një larmi e madhe poetike. Ajo është e lidhur ngushtë me kohën së cilës i përket. Kadare është poet qytetar. Poezia e tij është si një sizmograf shumë i ndjeshëm që reagon ndaj çdo ngjarje të rëndësishme. Besnik i stilit të tij konciz dhe i mënyrës së përgjithësimit, përmes detajit me forcën shprehëse.

Imazhi i qytetit industrial në poemën e Kadaresë është paraqitur si simbol i Shqipërisë së nesërme, të atdheut të industrializuar e të modernizuar, i shoqërisë së re të spastruar nga e vjetra, e njërit me moral e psikologji të re.

Ai ka në qendër të veprës së vet qytetin e ri industrial, konturet e të cilit i ndërton në përputhje me përfytyrimin e vet për të ardhmen Duke u nisur nga ky motiv poeti e zgjeron shumë rrethin e ideve që hyjnë në vepër, e cila tingëllon si një himn për të ardhmen e Shqipërisë.

Lidhur me temën e qytetit në letërsinë shqipe i pari që është shprehur për këtë çështje është Arshi Pipa në esenë “Barinjtë dhe fshatarët në letërsinë shqipe”¹ e cila është një analizë mbi letërsinë shqipe nga fillimet e saj deri në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar kur përfundon.

Ai ka mendimin se në letërsinë shqipe të kësaj periudhe pothuajse mungon tema apo më mirë tematika e qytetit. Përkundër kësaj ai mendon se tema e fshatarësisë përshkon tërë historinë e letërsisë shqipe, duke përfshirë edhe atë të diasporës.

Eseja identifikon dhe analizon tipat e fshatarësisë në traditat e ndryshme letrare, të cilët zhvillohen në formë delte. Nga këta tipa, disa prej të cilëve janë karakteristikë për tradita të caktuara letrare, si bujku arbëresh, bariu luftëtar gegë, fshatari i përzënë toskë, ka edhe një tip që është i përbashkët për të gjitha traditat dhe ky është banditi fshatar. Arsyeja për prevalencën e këtij tipi duhet kërkuar, sipas Pipës, në varfërinë e gjatë të fshatarësisë shqiptare. Letërsia tradicionale, sipas Pipës, e sublimon mungesën që krijon varfëria në heroizëm.

¹ Shih për më shumë: A. Pipa, *Trilogjia Albanica*, eseja *Barinjtë dhe fshatarët në letërsinë shqipe*, vëllimi 3, “Albanian Literature: Social Perspectives”, 1978, f. 78.

Edhe në esenë “Letërsia bashkëkohore dhe problemi i fshatarësisë”², vazhdon sërish këtë temë, e cila shihet në një kontekst të ri sociopolitik, ku shquan kolektivizimi i bujqësisë. Nga dy tipat antitezorë të përshkruar nga doktrina e realizmit socialist, raja-ja dhe kolkozniku, që karakterizojnë respektivisht periudhat parasocialiste dhe socialiste të letërsisë shqipe, i pari është jo realist (sipas Pipës), i krijuar për të justifikuar të dytin, i cili nga ana e tij është natyralistik më tepër sesa realist, një riprodhim mekanik i një tipi të ri social të punëtorit të bujqësisë. Realizmi socialist bëhet kështu një subjekt kritike. Pipa e nxjerr atë më tepër një lloj neoromanticizmi, çuditërisht shumë i ngjashëm me romantizmin e periudhës së Rilindjes Kombëtare, në aspektin e mbitheksimit të nacionalizmit, preferencës për shpërthime epike, dhe mbështetjen në folklor. Izolimi faktik politik i Shqipërisë shpjegon ringjalljen e nacionalizmit dhe frymën heroike dhe epike në letërsi dhe arte të cilin e nxiste aq shumë realizmi socialist.

Sipas Pipës, shkrimtari që i dha fund letërsisë tradicionale epiko-romantike dhe post-romantike ishte vetëm Migjeni. Ai ndërtoi në veprën e tij planimetrinë poetiko-letrare të një qyteti jo vetëm si strukturë (kisha, xhamia, sheshi qytetit, trotuar, rrugë qytetëse, punishte, karroca etj. etj.) por edhe si motive të cilat linden rriten dhe shpërthejnë vetëm në qytet e jo në fshat.

Megjithatë Pipa vë në dukje se disa shkrimtarë, si të brezit të ri ashtu edhe të brezit të vjetër të kohës, e kanë anashkaluar doktrinën në praktikën e tyre të shkruarit dhe kanë portretizuar aspekte të fshatarësisë që tregojnë etikën e tyre tradicionale, si edhe problemet e reja dhe të vjetra të jetesës së përditshme brenda kuadrit të statusit të ndryshuar sociopolitik.

Sigurisht që këtu bëhet fjalë për poetët dhe shkrimtarët e viteve 1960 mes të cilëve shquan Ismail Kadare, i cili në themel të projektit e tij të modernizimit të letërsisë shqipe vendosi qytetin dhe problematikën qytetare, jetesën, marrëdhëniet dhe sensibilitetet e jetës komunitare qytetare.

Në projektin letrar të Kadaresë spikat fuqishëm komponentja urbane e qytetare e shfaqur herë si dekor i qyteteve ekzistuese shqiptare, në ndërthurje të elementeve tradicionale me ato bashkëkohore, herë si vizione të qyteteve e qytezave të reja me kolorit industrial e punëtor dhe herë si përvoja nga *city* evropian e më gjerë. Komponentja urbane shquhet qysh në botimet e para të Kadaresë dhe më pas, vjen duke u konsoliduar deri sa shndërrohet në një karakteristikë themelore e poetikës së tij.

Kjo kumtesë synon të analizojë vizionin urban e industrial të këtij autori përmes leksikut, në etapën e parë të krijimtarisë së tij. Novatorizmi poetik i I. Kadaresë u realizua së pari nëpërmjet një leksiku të ri, të guximshëm e kurajoz. Në funksion të konceptit të vetë urban Kadare aktivizoi një grup të madh fjalësh e termash të natyrës teknike, industriale e shkencore me të cilat “ndërtoi” qendra të mëdha urbane të panjohura më parë në Shqipëri, qytete e qyteza, ku njerëzit do të inaguronin jetën e re komunitare.

² Po aty, f. 123.

Leksiku urban në fillimet e krijimtarisë së poetit Ismail Kadare

Zhvillimet e kohës në teknikë dhe në teknologji, në fillim të viteve '60, brenda dhe sidomos, jashtë vendit, kanë qenë në qendër të shqetësimeve poetike e estetike Kadaresë aq sa këtë çështje e trajtoi në një prej poezive më të spikatura të tij. Në këtë kuptim shqyrtimi i leksikut teknik, urban, industrial e qytetar në fillimet e krijimtarisë poetike të Kadaresë është gjithmonë një temë interesante studimi.

Për realizimin me sukses të tij, në formatin e një kumtese, kemi hetuar, vëzhguar dhe interpretuar këtë tip leksiku në disa nga poezitë dhe poemat në fillimet e hershme poetike të Kadaresë, siç janë: *Poezia dhe teknika*, *Plazhet në dimër*, *Ëndërr industriale*, *Lokomotiva*, *Motive për elektrifikimin e përgjithshëm të Shqipërisë*, *Poeme vjeshte*, *Antena*, *Kinema e vjetër*,³ etj.

Siç thotë studiuesi Jorgo Bullo "*Poet me fantazi të gjallë dhe me një vështrim original të jetës Kadareja e trajtoi në një mënyrë të veçantë temën e ndërtimit të vendit dhe arriti ta jap në një kënd të ri poetik, realitetin e kohës dhe atmosferën e vullshme që zotëronte në jetën e vendit*"⁴ Shpirti novator, mendimi artistik që ngrihet mbi fatet e thjeshta dhe depërton në kuptimin e tyre të përgjithësuar historik e filozofik, mënyra lirike e të rrëfyerit, leksiku i pasur urban që spikat fuqishëm në ndërtimin e asosacioneve dhe analogjive, përzjerja e temave dhe motiveve, janë veçori të talentit të Kadaresë.

5. Më poshtë po vijojmë me disa shembuj:

*Së shpejti do fillojnë anës detit shirat, / do mbyllen plazhet, do t'ikin kaltërsitë, / gjethet e verdha do fluturojnë sipër shinave, do bien ngadalë mbi shinën e celkitë. (Lokomotiva)*⁵

Në këtë poezi janë përdorur fjalë të leksikut urban si: *lokomotiva*, *shinat*, *plazhet*, *deti*. Njerëzit që shkojnë e vijnë në një qytet të madh nën re, nën shi, nën avionë, që dikur mbartnin zymtinë e divizioneve të luftës dhe sot mbajnë në krahë buzëqeshje vajzash të nxira nga dallgët.

Kurse tek poezia "*Poemë vjeshte*" hasim një areal fjalësh të leksikut urban si: *veturat*, *delegacioni*, *stola të lagur të parqeve*, *koncerte*, *orquestra telat*, *telegrame*, *telefona*, *tren*, *fotoaparati*, *apartament*, *oxhaqe*, *fabrika*.⁶ Përmes tyre autori realizon vizionin urban të viteve '60 që deri atëherë nuk ishte marrë në konsideratë në poezinë tonë. Në përfytyrimin e poetit vjen qyteti në një tjetër dimension, në një rikonceptim të zhvillimit të ri të qytetit: me fabrika, oxhaqe, apartamente, parqe. Qyteti formon një dimension të ri hapësinor, por edhe një imazh të ridimensionuar të zhvillimit intelektual.

*Telat e telefonëve dhe të telegramëve në hapësirë, / të nderura zgjaten drejt pafundësive, / nëpër telat e lagura, që çajnë qiellin e hirtë, / një telegram lamtumirë, do t'u dërgoj kaltërsive (Poemë vjeshte)*⁷

³ I. Kadare, *Motive me diell*, Tiranë, 1968.

⁴ Jorgo Bullo, *Studime për letërsinë shqiptare*, II, Tiranë, 1987, f. 504.

⁵ I. Kadare, *Poezi*, Tiranë, 1979, f. 132.

⁶ I. Kadare, *Poezi*, Tiranë, 1979, f. 138.

⁷ I. Kadare, *Poezi*, Tiranë, 1979, f. 138.

Fjalët e leksikut urban të përdorura qysh në hyrje të poemës: tela, telefon, telegram një komunikim ky modern për kohën, kur shkruan poeti. Duke qenë së Kadare është poet i mendimit, ku heroi lirik monologon me vete dhe me kohën, këmben me lehtësi rrafsh të rrëfimit poetik dhe duke sjellë larmi motivesh dhe idesh.

Jam si një shkop i ngritur drejt qiejve, / një copë hekur, për çdo milimetër imi, di më shumë gjuhë, se gjithë linguistët, të gjallë apo të vdekur (Antena)⁸

Përmes kësaj figure simbol, antena me gjuhën e çuditshme të valëve që kalon kontinentet, zbret në vizionin urban të Kadaresë dhe na jep një dimension të ri të qytetit që po rritet e zhvillohet çdo ditë: *“Kështu qëndroj dimër e verë, unë shkop i ngritur lart në eter”*.

“Në tërësinë e vetë poezia e Ismail Kadaresë ka sjellë në poezinë shqiptare një botë të tërë ndjenjash e idesh, ajo ka prekur sfera të reja të mendimit emocional. Fryma epike e epokës. lirizmi i vetvetishëm, mendimi i thellë i japin veçansinë poezisë së Kadaresë, si poet i cili pasuroi bashkë me përmbajtjen edhe llojet e poezisë shqiptare”⁹

Vepra e Kadaresë pasuroi jo vetëm fondin e ideve dhe problematikën e letërsisë sonë, por ajo solli larmi edhe në arsenalin e mjeteve, të përgjithësimit artistik, duke u bërë një faktor i rëndësishëm për ndryshimet që ndodhën në sistemin e gjinive letrare dhe në gjithë procesin e përtëritjes së formave artistike e të poetikës së llojeve.

⁸ I. Kadare, *Poezi*, Tiranë, 1979, f. 154.

⁹ J. Bullo, *Studime për letërsinë shqiptare*, II, Tiranë, 1987, f. 511.